



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	31416 / 26
Nr. i fq. / Br. st.	-
Data: / Datum:	17.07.2026
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri

Procesverbali nga dëgjimi buxhetor me banorët e fshatit Prelluzhë

Korrik 2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik me qytetarë për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Vushtrisë për vitin 2027, mbajtur me banorët e fshatit Prelluzhë.

Vendi: Shkolla e fshatit

Ora: 18:00

Data: 10.07.2026

Të pranishëm nga Komuna ishin Ymer Haradinaj, anëtar i Kuvendit, Stefan Markovic, anëtar i Kuvendit, Branislav Vuksanović, nga Zyra për Komunitete dhe Ekrem Merovci, nga Zyra për Komunitete.

Ymer Haradinaj, kryesues, hapi takimin me qytetarë dhe hapi debatin që qytetarët t'i paraqesin kërkesat e tyre.

Më pas fjala ka kaluar tek qytetarët pjesëmarrës në këtë takim për të paraqitur kërkesat e tyre.

Spasoje Stefanović, banor i fshatit Prelluzhë, propozon projektet e mëposhtme të infrastrukturës:

1. Rr.Car Llazarit (rindërtimi i rrugës) i dëmtuar gjatë përmbytjeve dhe ndërtimit të kanaleve të betonit me gjatësi 460 m.
2. Rruga pranë shkollës nuk është e asfaltuar , duhet të asfaltohet rreth 180 m.
3. Rruga Millosh Obiliçit, 600 m e gjatë, ka nevojë për mbushje me rërë.
4. Rruga e Zveçanit , ka nevojë për mbushje me rërë, në gjatësi rreth 240 m.
5. Rrugë për mbushje me rërë me gjatësi 180 m.
6. Problemi i ndriçimit publik në fshatin Prelluzhë 550m, nuk ka ndriçim në rrugën Nikola Tesla 800m, ka nevojë për rehabilitim të plotë të rrjetit të ndriçimit.
7. Rruga Milosh Obrenović, vazhdimi i ndërtimit të një trotuari me gjatësi prej 360 m.
8. Rindërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë në fshatin Prelluzhë.
9. Rehabilitimi i urës së lumit Sitnicë.
10. Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimeve për shkak të punimeve në ndërtimin e linjës hekurudhore. Një numër i madh i kapakëve janë dëmtuar.
11. Ndërtimi i policëve të shtrirë për trafik më të sigurt.

Nermin Shaqiri, banor i fshatit Prelluzhë, kërkoi ndriçim rrugor në Lagjen e Romëve me gjatësi 100 m.


Branislav Vuksanović, nga Zyra për Komunitete dhe banor i fshatit Prelluzhë, paraqiti këto kërkesa:

1. Rehabilitimi i bankinave në lumin Sitnicë për shkak të vërshimeve që ndodhën në vitet e mëparshme.
2. Rruga John Kennedy për ndriçim 450 m.

Gani Duraku, banor i fshatit Prelluzhë, kërkoi ndërtimin e sistemit të kanalizimeve në rrugën “Miftar Duraku” me gjatësi 350 m, dhe ndriçimi në këtë rrugë.


Procesmbajtës:

Branislav Vuksanoviç



Kryetarë i Komisionit

Ymer Hradinaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri



LISTA E PJESËMARRËSVE

Dëgjimet buxhetore për draft-buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027

Vendi: PRELLUZHË

Datë: 10.07.2026

Ora: 18:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Spasojë Stefović		Priluzje
2	Xhem Emini		Prelluzh
3	NERMIN SAGAJRI		Prelluzhë
4	Jon Derahe		Prelluzhë
5	Branislav Vuksanović		Priluzje
6	Stefan Molar		Prelluzhë
7	ERKAT MERKOV		K.K. Vushtri
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			